

VENDIM
Nr. 774, datë 15.12.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2.1, e vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.1 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2021, të jetë në masën 4 886 106 464 (katër miliardë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet, në formën e transfertës së pakushtëzuar, fondi në masën prej 4 839 106 464 (katër miliardë e tetëqind e tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh pa TVSH;

b) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 47 000 000 (dyzet e shtatë milionë) lekësh pa TVSH.”

2. Efektet financiare të përballohen nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2021.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj